



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 697/1.Prot

Gramsh më 26.02.2021

V E N D I M

Nr. 11 dt. 26/02/2021

“ Miratimin e vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Gezim Blogu, banues në fshatin Çekin, Njësia Administrative Pishaj, si dhe dëmshpërblim financiar”.

Këshilli i bashkisë në mbledhjen e tij të datës 26/02/2021, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Emergjencave Civile dhe Strehimit : “ Për miratimin vlerës financiare, të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Gezim Blogu, banues në fshatin Çekin, Njësia Administrative Pishaj, si dhe dëmshpërblim financiar”, bazuar në :

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:


1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **305 767 x 50% = 152 884** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Gezim Blogu** është në **152 884** (Njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **152 884** (Njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë, për shtetasin **Z. Gezim Blogu**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit të Prefektit.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini
Miratoi : G.Lena
Pranoi: G.Lena
Dosja nr: _____



KRYETARI I KËSHILLIT

